



PRISHTINE

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS (ATK-ë) – Divizioni i Ankesave (DA-ve) – në përbërje të panelit shqyrtues të kryesuar nga Mevlyde Berisha, anëtarë të panelit: Ilona Mrasori dhe Bashkim Paçarizi anëtare dhe procesmbajtës, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit tatimor [REDACTED] me numër unik identifikues [REDACTED] me menaxher [REDACTED] me adresë të biznesit [REDACTED], e dorëzuar në Divizionin e Ankesave me datë 14/11/2022 me nr. të protokollit 474/2022, kundër Vendimit mbi refuzimin e kërkesës për rimbursim datë 11/11/2022 me nr. protokollit 293/2022 e lëshuar nga Administrata Tatimore – Departamenti i Rimbursimeve dhe Qendra e Thirrjeve, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 24/11/2022, në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 03/L-222 „Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”, në prezencë të palëve procedurale: [REDACTED] - përfaqësues i biznesit me autorizim, Aziz Osmani- udhëheqës i Divizionit të Rimbursimeve, Zana Deda – zyrtare e rimbursimeve mori këtë:

VENDIM

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa Nr.474/2022 e datës 14/11/2022, e subjektit [REDACTED] me numër unik identifikues (NUI): [REDACTED] me menaxher [REDACTED] me adresë të biznesit fshati Kërpimehë – Podujevë.

II. Vendimi-njoftimi datë 11/11/2022 me nr. protokollit 293/2022 mbi refuzimin e kërkesës për rimbursim të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar nga Administrata Tatimore e Kosovës Departamenti i Rimbursimeve dhe Qendra e Thirrjeve, vërtetohet si i bazuar.

Arsyetim

Tatimpaguesi ka dorëzuar ankesë në Divizionin e Ankesave më datë 14/11/2022, ndaj vendimit- Njoftim Për Refuzimin e Kërkesës nr. 293/2022 të datës 11/11/2022 nga Departamenti i Rimbursimeve dhe Qendra e Thirrjeve, e që ankesa është parashtruar në afatin ligjor prej 30 ditësh e përcaktuar me nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222 “Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore”.

Njoftimi për Refuzimin e Kërkesës datë 11/11/2022 – Në bazë të kërkesës të datës 06/10/2022 në Departamentin e Rimbursimeve, pas analizës së lëndës e njëjta është refuzuar. Më tej në Njoftim potencohet se tatimpaguesi nuk ka përmbushur kushtet në bazë të nenit 30 të Ligjit 03/L-222 pika 1-6 dhe nenit 41 të ligjit 05/L-037 dhe nenit 59 të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2015. Kërkesa është refuzuar pasi që tatimpaguesi ka vjel TVSh-në e zbritshëm nga DUD-i para regjistrimit në TVSh(para datës 18/05/2022), i cili është i regjistruar në librin e blerje me datë 14/05/2022, dhe për të cilin import sipas gjendjes së

importeve në ATK nuk ka të dhëna për tatimpaguesin i cili ka bërë kërkesë për rimbursim. Po ashtu në librin e blerjes nuk janë paraqitur nr. personal ose nr. i fermerëve , ku blerjet kryesore janë nga fermerët për periudhat (shkurt mars 2022 te biznesi individual) Qershor, Korrik 2022 ku vlera e blerjeve për këto dy periudha të [REDACTED] është 113,685.93-TVSh 9,094.87€. Po ashtu tatimpaguesi ka shfrytëzuar TVSh e zbritshëm nga faturat e lëshuara nga Kesco të cilat nuk janë në emër të biznesit që ka kërkuar rimbursim

Ankesë-Tatimpaguesi në ankesën e datës 14/11/2022, e konteston vendimin - njoftimin e lëshuar nga ATK- Departamenti i Rimbursimeve dhe Qendra e Thirrjeve mbi refuzimin e rimbursimit si të pa bazë dhe në kundërshtim të plotë me procedurat ligjore ku më tej tatimpaguesi në ankesë potencon se arsyeja e parë e refuzimit është procesi i furnizimit , i bërë nëpërmjet importit (blerje e ambalazhit) proces i cili ishte i inicioar më herët dhe zhdoganimi i lëndës (Dud-it) R 7914 i datës 14/05/2022, ishte bërë konform ligjeve në fuqi dhe në emër të biznesit individual, sepse në këtë datë biznesi akoma ishte individual , por në proces të ndryshimit të statusit. Me datë 17/05/2022 kemi kaluar në SHPK duke ndryshuar kështu tipin e biznesit dhe për këtë e dëshmon " informata mbi biznesin , pjesë përbërëse e Certifikatës së biznesit. Përderisa është transferuar TVSh-ja e zbritshëm nga biznesi individual si është e mundur që mos të kemi të drejtën e vjeljes së TVSh-së për furnizimet nga 01 deri 17 maj 2022 dhe se me datë 17/05/2022 kur ka qenë dita e mbylljes së llogarisë tatimore , nuk ka qenë e mundur të bëhet deklarimi i transaksioneve në emër të biznesit individual, sepse siç e dini mundësia e deklarimit të TVSh-së ipet tek pas përfundimit të muajit. Po ashtu me tej tatimpaguesi në ankesë cek se arsyeja e refuzimit është bërë edhe për mosplotësim me nr. personal tek libri i blerjes , ku siç dihet në Udhëzuesin për plotësimin e librit të blerjes , tek rubrika e përshkrimit të plotësimit të kësaj rubrike shkruan se nuk është rubrikë mandatorë. Në lidhje me blerjet nga personat fizik , ne obligohemi të mbajmë tatimin në burim dhe me rastin e deklarimit të këtij lloj tatimi , ne obligohemi të bashkëngjisim tabelën e dizajnuar nga ana e ATK-së e cila tabelë patjetër kërkon edhe numrin personal të personave nga të cilët kemi blerje.

Dhe në fund të ankesës me shkrim tatimpaguesi bazuar në të lartcekurat kërkon nga Divizioni i Ankesave që të ndryshoj në plotni vendimin e refuzimit të kërkesës për rimbursim.

Divizioni i Ankesave në bazë të nenit 95 të Ligjit Nr. 05/L – 031 Mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative ka organizuar seancën e dëgjimit më datë 24/11/2022, në të cilën të pranishëm ishin të gjitha palët e ftuara në mënyrë të rregullt.

Përfaqësuesi i tatimpaguesit në të drejtën e fjalës theksoj se ankesa është bërë lidhur me refuzimin e kërkesës për rimbursim ku në ankesë kemi cek tri arsyet e refuzimit të rimbursimit. Arsyeja e parë mos pranimi i importit i cili është bërë në emër të biznesit individual, arsyeja e dytë blerjet nga fermerët për mungesë të numrave personal në librin e blerjes dhe mos njohja e TVSh-së së zbritshëm për faturat e energjisë elektrike në emër të biznesit individual. Biznesi " Kastrati " ShPK ka qenë biznes individual i cili ka ndërruar statusin nga individual në ShPK dhe fjala është për ambalazh. Importi është bërë nga biznesi individual dhe në atë kohë është bërë ndryshimi i statutit nga individual në ShPK , ku TVSh-ja e këtij importi nuk është pranuar. Po ashtu edhe faturat e energjisë elektrike nuk janë pranuar ku njehsori i rrymës është në emër të biznesit individual edhe pse është kërkuar nga KEK që të bëhen ndryshime në emër të njehsorit.

Sa i përket faturave të blerjes nga fermerët në librin e blerjes sistemi nuk ka lejuar të regjistrojë nr. e ID së fermerit (nr. personal) dhe në libër nuk është cekur regjistrimi i nr. personal të fermerëve dhe për ne nuk është rubrikë manadatore –obligative.

Zyrtari i rimbursimeve në të drejtën e fjalës thekson se ndryshimi i statutit nga individual në ShPK , problemi është se biznesi individual ka bërë transaksione edhe pas themelimit të SHPK-së dhe me datë 14/05/2022 është mbyll biznesi individual dhe me datë 18/05/2022 është bërë regjistrimi në ShPK dhe importi është bërë në emër të biznesit individual. Në librat

e shitjes dhe të blerjes je i obliguar të ceket nr. personal NUI apo NRF dhe në mungesë të këtyre informatave mund të refuzohet kërkesa e rimbursimit.

Administratat Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave pas shqyrtimit të ankesës, dhe administrimit dhe vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës dhe dispozitave ligjore, vlerësoi se ankesa e subjektit në procedurë është e pa bazuar.

Dispozitivi i këtij Vendimi të Divizionit të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim:

Divizioni i Ankesave pas shqyrtimit të vendimit –njoftimit mbi refuzimin e kërkesës për rimbursim të lëshuar nga Administratat Tatimore e Kosovës-Divizioni i Rimbursimeve, pas verifikimit të provave materiale në shkresat e lëndës, ballafaqimit të fakteve dhe analizimit me bazën ligjore, konstaton se ankesa e tatimpaguesit është e pa bazuar dhe mbetet në fuqi Vendimi i Divizionit të Rimbursimeve datë 11/11/2022.

Divizioni i Ankesave duke analizuar kërkesën e tatimpaguesit për rimbursim dhe njoftimin e regjionit për refuzim kërkesë së datës 06/10/2022, në bazë të fakteve, konstaton se Administrata Tatimore e Kosovës – Divizioni i Rimbursimeve ka vepruar komfor ligjeve në fuqi, Nenit 40 të Ligjit nr. 05/L-037 – Kërkesat për Rimbursim të TVSh-së

Sipas Divizionit të Ankesave tatimpaguesi me rastin e kërkesës për rimbursim nuk ka plotësuar kriteret ashtu siç parashihen me nenin 40 të Ligjit 05/L-037 gjegjësisht nenin 59 të Udhëzimit Administrativ nr.03/2015. Divizioni i Ankesave nga analizimi i dosjes në dispozicion konstaton se tatimpaguesi nuk ka mbajtur evidencën afariste (Librin e Blerjes) sipas legjislacionit tatimor që konsiderohen si deklarime të pasakta. Gjatë verifikimit është konstatuar se për blerjet nga persona fizik tatimpaguesit me rastin e deklarimit të librit të blerjes nuk ka përshkruar numri identifikues të blerësve pra nuk ka përmbushur të gjitha kriteret e parapara sipas paragrafit 1.2 të nenit 73 të Udhëzimit Administrativ 03/2015 për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSh dispozitë e cila parasheh; Libri i blerjes – Në këtë libër regjistrohet data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, të dhënat e deklaratës së importit (DUD), emri i shitësit, numri identifikimit tatimor dhe numri i TVSh-së së tij nëse ka. Po ashtu gjatë verifikimit është konstatuar se tatimpaguesi ka parregullsi në mbajtjen e librave dhe regjistrimeve, ku gjatë analizimit të librit të blerjes tatimpaguesi me datë 14/05/2022 ka regjistruar dhe ka vjel TVSh-në e zbritshëm për importin e realizuar me datë 14/05/2022 import i cili është realizuar në emër të biznesit individual ende pa qenë deklarues i TVSh-së subjekti juridik " V T Kastrati " (18.05.2022) si dhe ka shfrytëzuar TVSh-në e zbritshëm nga faturat e lëshuara nga Kesco, të cilat nuk janë në emër të biznesit që ka kërkuar rimbursim dhe se faturat e tilla për tu pranuar për Kastrati ShPK janë të papranueshme bazuar në nenin 44 dhe 45 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSh.

Andaj Divizioni i Ankesave konstaton se Divizioni i Rimbursimeve me të drejt ka refuzuar kërkesën për rimbursim bazuar në nenin 59 paragrafin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 dispozitë e cila parasheh: ATK do të refuzoj kërkesën për rimbursim të mjeteve nëse shumën e rimbursimit të kërkuar rezulton të jetë jo korrekte nga vlerësimi i ATK-së. Për shumën e mbi deklaruar do të aplikohen ndëshkime sipas Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat. *Ndërsa për shumën e vërtetuar nga ATK, tatimpaguesi mund të parashtrrojë kërkesë të re për rimbursim të mjeteve apo këtë kreditim ta bartë për periudhat vijuese.*

Në bazë të gjendjes së konstatuar duke pasur parasysh të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e në përputhje me nenin 132, paragrafi 2, të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Divizioni i Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi bazuar në Nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat" 03/L - 222, tatimpaguesi i pakënaqur ka të drejtë që brenda afatit (30) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të Divizioni i Ankesave, ta kundërshtojë këtë Vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr.474/2022 datë 13/12/2022

Vendimi t'iu dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi _____

Kryesuese e rastit
Mevlyde Berisha _____

